



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 3602 Prot

Vlorë, më 20.02 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2026

PËR

MIRATIMIN E TRANSFORMIMIT TË QENDRËS REZIDENCIALE PËR FËMIJË NË QENDËR TË SHËRBIMEVE PËR MBËSHTETJEN E FËMIJËS DHE FAMILJES

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika d të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, VKM nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij” VKB-në nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varfërisë dhe funksioneve të deleguara-2026”, Vendimin nr. 1 datë 04.04.2024 i Komitetit drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit, “Për miratimin e metodologjisë së transformimit të dy qendrave rezidenciale të përkujdesit për fëmijë, në Bashkitë Vlorë dhe Korçë, në Qendër të shërbimeve për mbështetjen e fëmijës dhe familjes” shkresa nr. 16822 prot. datë 16.10.2025 “Dërgim dokumentacioni në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 168 datë 29.09.2025 dhe shkresën nr. 2988 prot. datë 22.07.2025, hyrë në Bashki me nr. 12246 prot. datë 23.07.2025;

VENDOSI:

1. Transformimin e qendrës rezidenciale për fëmijë grupmosha 0-5 vjeç në “Qendër të Shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen”. Rregullorja e institucionit do të miratohet me vendim të Kryetarit të Bashkisë.
2. Në stafin e qendrës për shërbime mbështetëse për fëmijën dhe familjen do të përfshihet stafi i Shtëpisë së Foshnjes në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe stafi i Shërbimeve mbështetëse për fëmijët dhe familjen, në varësi të Bashkisë Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Qendra e Shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është angazhuar të transformojë shërbimet rezidenciale për fëmijë në shërbime komunitare, në mënyrë që bashkitë të mund të përdorin buxhetin e institucionit për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit parandalues dhe alternativ për fëmijën dhe familjen. Ky angazhim i Qeverisë Shqiptare filloi me miratimin e VKM nr.706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020-2022, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij”. Bashkia Vlorë, si bashki pilot e kësaj nisme ka miratuar me VKB nr.37, datë 27.05.2021 ngritjen e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen. Ngritja e këtij model shërbimi i parapriu procesit të deinstitutionalizimit duke aplikuar 3 shërbime të reja (shërbimet e fuqizimit të familjes, shërbimet e specializuara dhe shërbimi i kujdesit në familje.) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit të Deinstitutionalizimit, Drejtorisë së Buxhetit, bashkisë Vlorë, organizatave si Nisma Arsive e Fshatrat SOS dhe në mbështetje nga zyrat e UNICEF kanë realizuar Metodologjinë e transformimit të qendrës rezidenciale të përkujdesit shoqëror 0-5 vjeç me Vendim nr.01, datë 04.04.2024 “Për miratimin e Metodologjisë së Transformimit të dy Qendrave Rezidenciale të Përkujdesit për Fëmijë, në bashkitë Vlorë e Korçë, në Qendër të Shërbimeve Mbështetëse të Fëmijës dhe Familjes”.

Plani i transformimit propozon një model transformimi, i cili ruan buxhetin dhe burimet njerëzore, por mbulon në të njëjtën kohë boshllëkun ekzistues në sistemin e kujdesit të përkohshëm të emergjencës si dhe kujdesin alternativ të fëmijëve pa kujdes prindëror. Sipas këtij plani struktura dhe shërbimet e Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen do të integrohen me stafin e Institucionit të Përkujdesit Shoqëror 0-5 vjeç Vlorë për të formuar Qendrën e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen. Qendra për Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen vjen si rezultat i transformimit të institucioneve ekzistuese, për të ofruar shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familjet dhe një sistem alternativ të kujdesit në nivel rajonal, nën mbikqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social në bashki.

Qendra për Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen do të përfshijë këto tipologji shërbimesh :

1. Shërbim i strehimit të përkohshëm të emergjencës për fëmijët në rrezik dhe nënat me fëmijë (72 orë- 6 muaj)

Ky shërbim do të jetë në dispozicion 24/7, për një kohëzgjatje sipas nevojës nga 72 orë deri në 6 muaj, për të siguruar mbrojtjen e fëmijës dhe eksplorimin e të gjitha mundësive për fuqizimin e familjes apo kujdes alternativ. Ky shërbim do të jetë në katin e tretë të godinës ku ambienti do të jetë i ndarë dhe i përshtatur sipas grupmoshave të fëmijëve , 0-6, 6-15 dhe 15-18. Vendimi për vendosjen e fëmijës në qendër emergjence merret vetëm nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, kur rreziku i dëmtimit dhe risku është i lartë. Shërbimi i strehimit të përkohshëm emergjent do të ofrohet jo vetëm për fëmijët në territorin e bashkisë Vlorë, por edhe për fëmijë që do të referohen nga Shërbimi Social Shtetëror për aq kohë sa ky shërbim do të jetë me bashkëfinancim.

2- Shërbimet e specializuara

Ky është një shërbim që është pilotuar edhe nga SHMFF dhe konsiston në shërbime të specializuara të ofruara nga psikologë, terapistë, mësues special e profesionistë të tjerë (të jashtëm) që do të mbështesin fëmijët, nënat apo familjet kujdestare me shërbime sipas nevojës.

3- Shërbimet e fuqizimit të familjes

Shërbim i ngritur dhe i pilotuar nga SHMFF i cili përfshin vlerësimin dhe mbështetjen e fëmijës dhe familjes me synim parandalimin e ndarjes së fëmijës nga nëna dhe orientimin e familjes drejt gjithë shërbimeve që përmban Harta e shërbimeve sociale.

4- Shërbimi Mbështetës i Kujdesit Alternativ

Ky është një shërbim i ri i cili synon evidentimin e familjeve kujdestare alternative dhe njëkohësisht përgatitjen e fëmijëve për ribashkim me familjen biologjike.

5- Shërbimet Mbështetëse në Familje

6- Shërbimi ditor për fëmijët në risk, fëmijët në nevojë apo ata që kanë dalë nga shërbimi rezidencial.

Ky shërbim do të ofrohet për fëmijët që kanë nevojë të mbështeten me shërbim ditor pas shkolle, të asistohen nga edukatorët për kryerjen e detyrave të shtëpisë, ushqim dhe edukim.

7- Shërbime të mbështetjes në familje dhe kujdesit afatshkurtër.

Përfshin mbështetje për fëmijët dhe familjet në banesën e familjes ose kujdestarit për periudha të shkurtra kohore bazuar në nevojat shëndetësore ose sociale të tyre.

Hapat e transformimit

Krijimi i Qendrës së Shërbimit Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen do të vijojë edhe me hapa të tjerë të rëndësishëm si, kontratat e reja të punës sipas shërbimeve të reja, hartimi i rregullores së re, përgatitja e dokumentacionit të ri për shërbimet e reja dhe ndërthurja me manualët dhe dokumentacionin aktual të SHMFF, financimi dhe administrimi i Qendrës, përgatitja dhe miratimi i standarteve të reja të shërbimit të Qendrës.

Monitorimi

Drejtori i Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimit Social do të ketë përgjegjësinë që të ndjekë e të monitorojë zbatimin e planit të transformimit të shërbimit rezidencial në Qendër të Shërbimeve Mbështetëse të Fëmijëve dhe Familjes në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Drejtor i Ndihmës dhe Shërbimit Social

Irena Srasa



Drejtor i Qendrës së Shërbimeve për Mbështetjen e Fëmijës dhe Familjen

Ariela Çuçi



KRYETAR
Brunilda Mersini

